

---

**ANALYSIS OF PHONETIC, GRAMMATICAL AND LEXICAL SKILLS OF ENGLISH LANGUAGE STUDENTS IN THE TECHNICAL SCHOOL "LUTFI MUSIQI" IN VUSHTRRI**

**Albulena Pllana Breznica**

High Technical Scholl "Lutfi Musiqi" Vushtrri, Republic of Kosova

[aalbulena.p@gmail.com](mailto:aalbulena.p@gmail.com)

**Fisnike G. Pllana**

University of Prishtina "Hasan Prishtina" Department of English Languages and Literature

[fnisnike\\_p@hotmail.com](mailto:fnisnike_p@hotmail.com)

**Abstract:** In this paper, an analysis of the English language knowledge of students (100 students were tested) at the technical high school "Lutfi Musiqi" in Vushtrri was conducted. Based on tests with 100 pupils (four classes, fourth grade), scores on phonetic errors, grammatical errors, essay writing errors, technical pronunciation errors, and common words as well as in lexicon have been obtained. Given the fact that there is no English language laboratory in the school and there is a change of professors in the process of teaching the English language in lower secondary schools, students of the XII class still make mistakes. Therefore, a permanent engagement of English language professors is required to achieve higher results in English language acquisition. The results of the analysis and the study are presented graphically. A certain number of students (about 25%) have the English language acquisition, so they do not make mistakes in pronunciation, in speech, have adopted grammar and have the knowledge of technical terms.

**Keywords:** the English language, phonetics, grammar, lexicon, technical high school.

**ANALIZË E NJOHURIVE FONETIKE, GRAMATIKORE DHE LEKSIKORE TË NXËNËSVE PËR GJUHË ANGLEZE NË SHKOLLËN E MESME TEKNIKE "LUTFI MUSIQI" NË VUSHTRRI**

**Albulena Pllana Breznica**

High Technical Scholl "Lutfi Musiqi" Vushtrri, Republic of Kosova

[aalbulena.p@gmail.com](mailto:aalbulena.p@gmail.com)

**Fisnike G. Pllana**

University of Prishtina "Hasan Prishtina" Department of English Languages and Literature

[fnisnike\\_p@hotmail.com](mailto:fnisnike_p@hotmail.com)

**Përmbledhje:** Në këtë punim është bërë një analizë e njohurive nga gjuha angleze e nxënësve (janë testuar 100 nxënës) në shkollën e mesme teknike „Lutfi Musiqi” në Vushtrri. Në bazë të testeve me 100 nxënës (katër paralele, klasa e XII-të) janë fituar rezultate lidhur me gabimet në fonetikë, gabimet gramatikore, gabimet gjatë shkrimit të eseve, gabimet gjatë shqiptimit të termave teknikë dhe fjalëve të zakonshme si edhe në leksik. Duke u nisur nga fakti se nuk ka laborator të gjuhës angleze në shkollë, si edhe ndërrimi i profesorëve gjatë mësimit të gjuhës angleze në shkollat e mesme të ulëta, nxënësit e klasave të XII-ta bëjnë ende gabime. Andaj, kërkohet një angazhim i përhershëm i profesorëve të gjuhës angleze për të mbërri rezultate sa më larta në përvetësimin e gjuhës angleze. Rezultat e analizës dhe studimit janë paraqitur në formë grafike. Një numër i caktuar nxënësisht (rreth 25%) kanë arrijtë përvetësimin e gjuhës angleze, pra nuk bëjnë gabime në shqiptim, në të folur, kanë përvetësuar gramatikën dhe kanë njohuri të termave teknikë.

**Fjalët çelës:** gjuha angleze, fonetikë, gramatikë, leksik, shkolla mesme teknike.

## **1. HYRJJE**

Duke u nisur nga fakti se gjuha angleze është gjuhë shtetërore në SHBA, në Britaninë e Madhe, në Kanada (krahas frëngjishtes), në Australi, në Zelendën e Re dhe në Afrikën e Jugut. Gjuha angleze është gjuhë shtetërore ose zyrtare edhe në një varg shtetesh të tjera të Afrikës. Aglishtja zë një vend jo të vogël në jetën politike, ekonomike e kulturore të Pakistanit e të Indisë. Jo rrallë, ajo përdoret si gjuhë e tregtisë e shkencës dhe e publicistikës në Azi, Afrikë e pjesërisht në Amerikën e Jugut. Sot, në tërë botën, me miliona njerëz e flasin dhe e shkruajnë atë si gjuhë të dytë.

Fjalët angleze ose me prejardhje nga anglishtja kanë hyrë si terma në fusha të veçanta të veprimtarisë shoqërore.

Siç dihet, shqipja ka aftësinë t'i përvetësojë fjalët e huaja, domethënë ato, thuajse nuk ndihen si të tilla për nga përbërja fonemore, për nga shkrimi, për nga struktura gramatikore etj. Kjo vlen edhe për fjalët angleze. Siç vëren prof. A. Kostallari<sup>27</sup>, anglicizmat “*nuk kanë mbetur e nuk përdoren në trajtën e anglishtes, por në përgjithësi janë asimiluar nga struktura fonetike e gramatikore e shqipes*”.

Fjalët angleze në shqipen janë kryesisht të njëkuptimshme, kurse në anglishte të tilla njësi kanë përgjithësisht më shumë se një kuptim. Kjo do të thotë që struktura kuptimore e fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën shqipe është shumë e ngushtë e pa mundësi për t'u zgjeruar më tej. Kur hyjnë si terma, vetëkuptohet që fjalët angleze ose me prejardhje nga anglishtja janë të njëkuptimshme. Njëkuptimsia lidhet me funksionimin e me ndonjë kuptimi joterminologjik, ajo do të ketë përdorim të kufizuar sepse nga pikëpamja stilistikore I përket leksikut libror.

## 2. GJUHA SISTEM

Siç dihet, gjuha është sistem dhe, si çdo sistem teknik, ka anën e vet funksionale:

- *ligjërimin*, i cili është një veprimtari e ndërjegjeshme dhe shumë specifike, e cila realizohet në formë gojore dhe librare,
- anën *receptive*, që përfshin dëgjimin dhe shkrimin,
- anën *produktive*, që përfshin të folurit dhe shkrimin.


Të mësuarit e gjuhës së huaj, në këtë rast i gjuhës angleze, nga ana e nxënësve në shkollën e mesme teknike „Lutfi Musiqi“ në Vushtri, është një proces jashtëzakonisht i përbërë, që përfshin:

- **njohjen e materialit konkret gjuhësor:** *fonetik, gramatikor dhe leksikor*, ku te nxënësit e klasave të XII-ta parë ka një laryshi njohurish nga shkollat e mesme të ulëta, pasi që një numër jo i madh i nxënësve vijnë nga fshatra të ndryshme të qytetit të Vushtrrisë. Gjithashtu ka dallime edhe nga ana fonetike, pasi që disa nxënës nuk kanë pasur arsimtarë të kualifikuar në shkolla e mesme të ulëta.

Në bazë të testeve me 100 nxënës (katër paralele, klasa e XII-të) në shkollën e mesme teknike „Lutfi Musiqi“ në Vushtri, janë fituar rezultate lidhur me *gabimet në fonetikë, gabimet gramatikore, gabimet gjatë shkrimit të eseve, gabimet gjatë shqiptimit të fjalëve të zakonshme, të termave teknike dhe si edhe në leksi*.

**Gabimet në fonetikë:** Duke u nisur nga fakti se nuk ka laborator të gjuhës angleze në shkollë, si edhe nga ndërrimi i profesorëve gjatë mësimit të gjuhës angleze në shkollat e mesme të ulëta, nxënësit e klasave të XII-ta bëjnë ende gabime fonetike.


Në digramin vijues paraqiten gabimet fonetike gjatë shqiptimit të fjalëve të zakonshme dhe të termave teknikë:



Në digramin vijues paraqiten gabimet gjatë shkrimit të eseve të fjalëve të zakonshme dhe të termave teknikë:


<sup>27</sup> A. Kostallari, “*Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturave të gjuhës sonë*“, në „Sf“, Tiranë, 1982, 2, f. 28-30.

**Gabimet gjatë shkrimit të eseve: 100 nxënës  
(katër paralele, klasa e XII-të)**



Në digramin vijues paraqiten gabimet gramatikore gjatë leximit dhe shqiptimit të fjalëve të zakonshme dhe të termave teknikë:


**Gabimet gramatikore: 100 nxënës (katër  
paralele, klasa e XII-të)**



- **aftësitë dhe shprehjet në dëgjim e në folur:** në *lexim* e *shkrim*. Shumica e nxënësve lexojnë pa gabime, kurse ka gabime gjatë shkrimit kryesisht të termave teknike.


Në digramin vijues paraqiten gabimet gjatë leximit të fjalëve të zakonshme dhe të termave teknikë:

**Gabimet gjatë leximit të fjalëve të zakonshme  
dhe të termave teknikë: 100 nxënës (katër  
paralele, klasa e XII-të)**



- **tematikën**, në mbështje të së cilës bëhet *komunikimi gojor dhe libror*. Lidhur me këtë, ka ngecje sidomos në komunikim libror.

Në diagramin vijues do të parqiten gabimet gjatë *komunikimi gojor dhe libror*:



## PËRFUNDIM

Tek nxënësit, në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, ndeshemi me një mospërputhje me njohuritë paraprake nga shkollat e mesme të ulëta, në të cilat ende nuk ka kërkesa sasiore dhe cilësore të përcaktuara saktë për shkathtësitë në aspektet kryesore të ligjëritimit, për hyrje me lehtësi në nivelet e ndryshme të përfeksionimit të gjuhës angleze.

Në shkollat e mesme, në bazë të planprogrameve, leximi dhe të folurit zënë vendin kryesor, kurse shkrimi përdoret si mjet ndihmës për përvetësimin e leximit dhe të të folurit.

Zotërimi i të folurit rrjedhshëm, me një leksik të plotë, sipas kërkesave të kohës nga fushat teknike, parakupton një mori faktorësh të ndërlydhur, që kushtëzojnë përvetësimin e qëndrueshëm të dijeve, shprehive dhe veprimtarisë ligjërimore të gjuhës angleze.

Roli i të ushtruarit intensive dhe i praktikës nuk duhet mohuar, andaj duhet praktikuar numër më të vogël në një grup të nxënësve, për formimin e shprehive dhe shkathtësive të të folurit. Rruga ekstenzive e përvetësimit të të folurit është e papërshtatshme për nxënësit tanë edhe për faktin se mungon mjedisi gjuhësor, zgjatë koha e përvetësimit të gjuhës dhe ulet cilësia.

Tek nxënësit tanë, rezultate të kënaqshme do të fitoheshim me ushtrime leksiko-gramatikore, ose duke u mbështetur kryesisht në tekstet e shkruara.

Mungesa e laboratoreve fonetike në shkollat e mesme të Republikës së Kosovës, e, tani kjo mungesë është edhe në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri, pasqyrohet në rezultatet e pamjaftueshme që vihen re në përvetësimin e gjuhës angleze nga nxënësit. Andaj, është e domosdoshme që shkolla të pajiset me laborë bashkëkohorë të gjuhës angleze, me literaturë të kohës, për mësimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze, d.m.th. të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Kërkesë e kohës është edhe përvetësimi i shkathtësive për shkrimin e shkresave teknike dhe të eseve nga fushat teknike, me kriteret gjuhësore, pa gabime drejtshkrimore si në rrafshin e gramatikës ashtu edhe të sintaksës.

## LITERATURA

[1] Duro, A.: “*Terminologjia si sistem*”, PANTEON, Tiranë, 2001.

[2] Pllana, G.: “Formimi i terminologjive teknike shqipe mbi bazën e leksikut të përgjithshëm”, QSA IGJL, Tiranë, 2017.

[3] Pllana, S.; Breznica, P.A.: “*Overview of individual processing of the albanian technical terminology*” Thirteenth

International Scientific Conference THE TEACHER OF THE FUTUR, 25-28.5.2017, Budva, Montenegro, Internationa Journal KNOWLEDGE UDK 37 Scientific Papers Vol. 17.4, Skopje 2017.

[4] Thomai, J.: “*Ligjërata pasuniversitare (leksikologji, semantikë, leksikologji)*”, Korçë, 2015.

[5] Breznica, P.A.; Pllana, Z.; Pllana, F.: ““*Overview of english for specific purposes in a technical higc school “Lutfi Musiqi” in Vushtrri*”” Journal of Educational and Social Research, Vol 7, No 2 (2017), Roma, Itali.